



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 893/3 prot

Datë 09.05.2023

V E N D I M
Nr. 344/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.05.2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “NRG” SHPK nga autoriteti kontraktor, në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-66555-04-19-2023, me objekt: Loti 2 “Shërbim Dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Lezhë”, me fond limit 9.903.240 lekë (pa tvsh), parashikuar për t’u zhvilluar në datë 22.05.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

Vazhdimi i procedurës së shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.

Autoriteti Kontraktor:

Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nd.1, 1001, Tiranë

Ankimues:

Operatori ekonomik “NRG” SHPK
Farkë, Rruga “Eduart Mano”, Pallatet Nr.10, Kopshti Zologjik, Selitë, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave

për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 20.04.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-66555-04-19-2023, me objekt: Loti 2 “Shërbim Dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Lezhë”, me fond limit 9.903.240 lekë (pa tvsh), parashikuar për t’u zhvilluar në datë 22.05.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 26.04.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 893 prot., e operatorit ekonomik “NRG” SHPK, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Me anë të shkresës nr. 617/4 prot., datë 03.05.2023, protokolluar me tonën me nr. 893/2 prot., datë 05.05.2023 me objekt “Dërgim dokumentacioni për procedurën e prokurimit me objekt “Shërbim dezinfektimi”, ndarë në 6 (gjashtë) Lote”, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Publik informacion në lidhje me procedurën e prokurimit, si dhe bashkëlidhur ka dërguar aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, me nr. 613/2 prot., datë 02.05.2023, me objekt “Vendim mbi shqyrtimin e ankesës së ankimuesit “NRG” SHPK”, ku konstatohet se e ka pranuar pjesërisht atë, si më poshtë:

“[...]

Operatori ekonomik, “NRG” SHPK ka ankimuar kriterin e përcaktuar në pikën 1, të seksionit 2.3 “Kapaciteti teknik”, në dokumentat e tenderit, me pretendimin si vijon: “Kërkojmë që ky kriter të modifikohet sipas pikës 3 të nenit 41 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar. [...]

Bazuar në sa më sipër, KSHA gjykon se duhet të kryhet modifikimi i kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.1, duke riformuluar kriterin kualifikues lidhur me dokumentacionin e kërkuar për përvojën e mëparshme të ngjashme të realizuar me sektorin publik, duke e lënë atë opsional dhe duke i dhënë mundësinë operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm për paraqitjen lidhur me dëshminë e përvojës së mëparshme në format e përcaktuara në VKM 285/2021.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues lidhur me këtë pikë pranohet.”

III

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit për modifikimin e dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Referuar shkresës nr. 617/4 prot., datë 03.05.2023, protokolluar me tonën me nr. 893/2 prot., datë 05.05.2023 me objekt “Dërgim dokumentacioni për procedurën e prokurimit me objekt “Shërbim dezinfektimi”, ndarë në 6 (gjashtë) Lote”, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Publik informacion në lidhje me procedurën e prokurimit, si dhe bashkëlidhur ka dërguar aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, me nr. 613/2 prot., datë 02.05.2023, me objekt “Vendim mbi shqyrtimin e ankesës së ankimuesit “NRG” SHPK”, ku konstatohet se e ka pranuar pjesërisht atë, si më poshtë:

“[...]

Operatori ekonomik, “NRG” SHPK ka ankimuar kriterin e përcaktuar në pikën 1, të seksionit 2.3 “Kapaciteti teknik”, në dokumentat e tenderit, me pretendimin si vijon: “Kërkojmë që ky kriter të modifikohet sipas pikës 3 të nenit 41 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar. [...]

Bazuar në sa më sipër, KSHA gjykon se duhet të kryhet modifikimi i kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.1, duke riformuluar kriterin kualifikues lidhur me dokumentacionin e kërkuar për përvojën e mëparshme të ngjashme të realizuar me sektorin publik, duke e lënë atë opsional dhe duke i dhënë mundësinë operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm për paraqitjen lidhur me dëshminë e përvojës së mëparshme në format e përcaktuara në VKM 285/2021.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues lidhur me këtë pikë pranohet.”

II.1.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se : Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe pikat 1 dhe 2 të nenit 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik

gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-66555-04-19-2023, me objekt: Loti 2 “*Shërbim Dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Lezhë*”, me fond limit 9.903.240 lekë (pa tvsh), parashikuar për t’u zhvilluar në datë 22.05.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.
2. Të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.
3. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaïd Myzyri